



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-04

**Vendosi:** **Paneli i Gjykatës së Dhomës së Apelit**  
Gjykatëse Mishelë Pikar  
Gjykatës Emilio Gati  
Gjykatëse Nina Jorgensen

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 20 dhjetor 2021

**Gjuha origjinale:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim në lidhje me Kërkesën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar për  
Ndryshimin e Afatit**

---

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar:**  
Xhek Smith

**Mbrojtësit të Pjetër Shalës:**  
Zhan-Lui Zhilisen

**PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT** të Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht “Paneli i Gjykatës së Apelit”, “Paneli i Apelit” ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”),<sup>1</sup> bazuar në nenin 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 169 të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), ka marrë në shqyrtim kërkesën e parashtruar nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (përkatësisht, “Kërkesa” dhe “ZPS-ja”)<sup>2</sup> për zgjatjen e afatit të paraqitjes së përgjigjes ndaj Apelit të Pjetër Shalës, (përkatësisht, “Përgjigjja”, “Shala” dhe “Apeli”)<sup>3</sup> kundër “Vendimit mbi Mocionin për Mangësi në Formën e Aktakuzës” të Gjykatësit të Procedurës Paraprake.<sup>4</sup> ZPS-ja kërkon një zgjatje afati prej pesë ditësh për dhënien e Përgjigjes, pra deri më 10 janar 2022.<sup>5</sup>

1. ZPS-ja parashtron se ekzistojnë arsye të vlefshme për miratimin e zgjatjes së arsyeshme dhe proporcionale të afatit sepse: (i) afatet e tanishme për Apelin dhe Përgjigjen bien pikërisht para dhe gjatë pushimit dimëror, përkatësisht; (ii) ZPS-ja ka afate ekzistuese për çështjen (për shembull afati për dosjen paraprake është janari 2022) që kërkojnë punë gjatë pushimeve; dhe (iii) problemet e reja dhe komplekse të autorizuar për apel kërkojnë shqyrtim të kujdesshëm dhe të duhur për përgatitjen e parashtrimeve të përqendruara dhe të plota.<sup>6</sup>

2. Paneli vëren se, sipas rregullës 170(2) të Rregullores, Përgjigjja duhet të paraqitet normalisht dhjetë ditë pas shpërndarjes së Apelit. Paneli gjithsesi sjell në

---

<sup>1</sup> F00001, Vendim për caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 2 dhjetor 2021.

<sup>2</sup> F00005, Kërkesë e Prokurorisë për zgjatjen e afatit për t’iu përgjigjur ‘Kërkesës së Mbrojtjes për Zgjatje të Afatit për të Apeluar ‘Vendimin mbi Mocionin e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës’, 15 dhjetor 2021 (“Kërkesa”). Pavarësisht nga titulli i Kërkesës, ZPS-ja nuk kërkon zgjatjen e afatit për t’iu përgjigjur kërkesës së Shalës për zgjatjen e afatit të Apelit, por ZPS-ja kërkon zgjatjen e afatit për t’iu përgjigjur vetë Apelit.

<sup>3</sup> F00004, Apel i Mbrojtjes me Leje kundër ‘Vendimit mbi Mocionin për Mangësi në Formën e Aktakuzës’ (“Apeli”).

<sup>4</sup> F00089/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Mocionit për Mangësi në Formën e Aktakuzës’, 18 tetor 2021.

<sup>5</sup> Kërkesa, para. 1.

<sup>6</sup> Kërkesa, para. 4.

vëmendje se rregulla 9(5)(a) e Rregullores lejon ndryshimin e çdo afati të përcaktuar në Rregullore kundrejt paraqitjes së një arsyeje të vlefshme ose *proprio motu*.

3. Penali i Apelit vëren se, bazuar në një arsye të vlefshme, e ka zgjatur tashmë afatin për paraqitjen e Përgjigjes deri më 5 janar 2022, në përputhje me zgjatjen analoge të miratuar për Apelin.<sup>7</sup> Megjithatë, në rrethanat e veçanta të kësaj çështjeje, dhe për arsye të jashtëzakonshme bazuar në parashtrimet e ZSP-së,<sup>8</sup> Paneli është i mendimit se koha shtesë do ta ndihmonte ZSP-në për të përgatitur parashtrime të njëmendta dhe e konsideron si të arsyeshme zgjatjen e kërkuar të afatit. Paneli në mënyrë të veçantë mban parasysh se zgjatja e kërkuar nuk do të cenojë zhvillimin e shpejtë të procesit në tërësi.

4. Së fundi, Paneli rikujton se në bazë të rregullës 9(6) të Rregullores, mocioni për ndryshimin e afateve mund të trajtohet pa u dhënë mundësinë palëve për t'u dëgjuar. Duke qenë se Mbrojtjes nuk do t'i shkaktohet paragjykim, Paneli konsideron se është në interes të drejtësisë që të vendosë menjëherë lidhur me Kërkesën.

5. Për këto arsye, Paneli i Gjykatës së Apelit:

**MIRATON** Kërkesën; dhe

**AUTORIZON** ZPS-në të paraqesë Përgjigjen jo më vonë se data 10 janar 2022.

---

<sup>7</sup> Mesazh elektronik i datës 10 dhjetor 2021 nga Njësia për Administrimin e Gjykatës drejtuar palëve.

<sup>8</sup> Përgjigjja, para. 4.

/nënshkrim/

---

**Gjykatëse Mishelë Pikar,  
Kryegjykatëse**

E hënë, 20 dhjetor 2021

Në Hagë, Holandë